



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR  
NË DREJTIMIN MËSIMOR “MEKANIKË”, NIVELI III**

TIRANË, 2015

**Programi orientues** për provimet përfundimtare të drejtimit mësimor **"Mekanikë"**, **Niveli III** përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë drejtim mësimor, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

## **Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në drejtimin mësimor **"Mekanikë"**, **Niveli III** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**a) Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyra komplekse e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

<b>Nr</b>	<b>Kompetenca profesionale</b>	<b>Pikët</b>	<b>Detyra komplekse e punës</b>
1	Të përgatisë vizatimin e detaleve të nyjes	15	Nxënësit i jepet vizatimi i një nyjeje mekanike të thjeshtë, funksionet që kryen dhe ngarkesat që veprojnë. Brenda kohës së provimit praktik, nxënësi duhet të
2	Të përcaktojë procesin teknologjik të prodhimit të nyjes	15	
3	Të përzgjedhë, përdorë dhe mirëmbajë veglat, instrumentet, pajisjet, makinat dhe materialet e punës	10	

4	Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit	10	përgatisë vizatimin e punës, të përcaktojë procesin teknologjik të prodhimit dhe të prodhojë pjesët e nyjes teknologjike, duke përdorur makinat, veglat dhe instrumentet përkatëse.
5	Të kryejë matje dhe kontrolle	5	
6	Të kryejë proceset e punës (tornime, frezime, zdrugime, shpime etj.) për prodhimin e nyjes	35	
7	Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera	10	
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>	

**b) Skema e vlerësimit me nota:**

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

**Shënime:**

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve “*me detyrë komplekse pune*” (në kollonën e tretë të tabelës së parë tregohet detyra komplekse e punës).
- Nxënësit do të vlerësohen për **7 kompetenca bazë**, të cilat do të verifikohen nga Komisioni i provimit duke vëzhguar nxënësin gjatë projektimit dhe prodhimit të nyjes mekanike.
- Rekomandohet që, gjatë hartimit të listës së kontrollit për përmbushjen e secilës prej detyrave, të parashikohet edhe ***bashkëbisedimi profesional*** ndërmjet instruktorit dhe nxënësit, në vartësi kjo të peshës/rëndësisë që ka ky element në kompetencën profesionale përkatëse.